



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Nr. Prot. Org. Jednica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot. Org. Jednica Org. Unit	758-2/20
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	06
Data. Datum. Date.	12.08.2020
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	02.06.2026
REFERENC-Ë:	26/758/113/DMM
PËR/ZA/TO:	"Esha Materials" L.L.C. Hani i Elezit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/758/113/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Esha Materials" L.L.C. Hani i Elezit, për eksploatimin e gurit gëlqeror në mihjen sipërfaqësore "Seçishtë" në Seçishtë, Hani i Elezit.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Esha Materials" L.L.C. Hani i Elezit, me nr. prot.: 26/758/113/DMM, pajiset me Pëlqim Mjedisor për eksploatimin e gurit gëlqeror në mihjen sipërfaqësore "Seçishtë" në ngastren kadastrale Nr. P-733170079-01116-0 në Seçishtë, Hani i Elezit, për koordinatat



Koordinatat e Sip=73035m ² të përkufizuar për eksploitim të gurit gëlqeror		
Pikat	Y	X
1	7525523.240	4663504.200
2	7525422.570	4663442.260
3	7525376.630	4663441.830
4	7525349.510	4663050.660
5	7525582.220	4663121.630

S=73035 m2

nën kushtet si vijon:

Kushtet mjedisore që duhet të zbatohen gjatë realizimit të projektit:

- Gjatë procesit teknologjik duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e ndotjes së mjedisit, duke përfshirë:
 - menaxhimin e duhur të mbeturinave të ngurta;
 - parandalimin e derdhjes së vajrave nga makineritë dhe pajisjet;
 - parandalimin e derdhjes së karburanteve, veçanërisht gjatë furnizimit të makinerive.
- Të instalohet sistem i spërkatjes me ujë me qëllim të parandalimit të përhapjes së pluhurit në ajër dhe bartjes së tij nga era drejt zonave të banuara.
- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operacionale dhe të hapet kanal rreth zonës së mihjes për mbledhjen e ujërave atmosferike të ndotura, të cilat duhet të orientohen në pusët sedimentuese për trajtim, në afat prej dy (2) muajsh nga data e marrjes së këtij Pëlqimi Mjedisor.
- Të rregullohen dhe funksionalizohen pajisjet për trajtimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet operacionale (pusët sedimentuese dhe separatori i vajrave), në afat prej dy (2) muajsh nga data e marrjes së këtij Pëlqimi Mjedisor.
- Të vendosen pajisje dhe kontejnerë adekuatë për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta.
- Në përputhje me Ligjin për Ujërat Nr. 04/L-147, neni 48, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve dhe brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore, ndalohet ndërtimi i objekteve që nuk shërbejnë për mbrojtje nga përmbytjet në një distancë më të vogël se 30 metra nga vija e ujërave të larta.

Faqe 3 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja " kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

7. Gjatë periudhave të thata dhe me temperatura të larta, rrugët e paasfaltuara duhet të spërkatën periodikisht me ujë për të zvogëluar emetimin e pluhurit gjatë transportit.
8. Kamionët që transportojnë gur gëlqeror ose material tjetër mineral duhet të pajisen me mbulesë adekuate për të parandaluar shpërndarjen e materialit dhe pluhurit gjatë transportit.
9. Pas përfundimit të aktiviteteve të shfrytëzimit, të kryhet rikultivimi i zonës së shfrytëzuar në përputhje me projektin e miratuar të rikultivimit.
10. Të bëhet rrethimi i ngastrës me gardh ose tel gjembor, me qëllim të rritjes së sigurisë dhe kufizimit të qasjes së paautorizuar në zonën e aktivitetit.
11. Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania "Esha Materials" L.L.C. Hani i Elezit, me nr. prot.: 26/758/113/DMM, për Pëlqim Mjedisor për eksploatimin e gurit gëlqeror në mihjen sipërfaqësore "Seçishtë" në ngastren kadastrale Nr. P-733170079-01116-0 në Seçishtë, Hani i Elezit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.
Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Vërejtje: Vonesa në dhënien e përgjigjes është shkaktuar si rezultat i volumit të madh të kërkesave në procedurë dhe ndryshimit të përbërjes së Komisionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). Informohet se shqyrtimi i lëndës deri në fazën e mbajtjes së debatit publik është kryer nga Komisioni paraparak.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/758/ZSP/ /26 datë: 02.06.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Hani i Elezit
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPH



UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

